



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva**

Nr. 13-111/01-0012724/21

Dt. 15.02.2021

Bazuar në Nenin 67 dhe 68 të Ligjit për Zyrtarët Publik të Republikës së Kosovës, Nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës si dhe në bazë të kërkesës së QKMF - ës, Komuna e Podujevës shpall:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

I. Pozita: Mjek/e Specialist të Mjekësisë Familjare ose Mjek/e të Përgjithshëm i QKMF- së në Podujevë, 9 (nëntë) pozita

Koeficienti: H-20 / H - 27

Lloji i vendit të punës: Me afat të pacaktuar, me orar të plotë (Periudha provuese 6 muaj)

Përshkrimi i detyrave të punës:

- Ofron mbrojtjen primare shëndetësore për pacientin dhe familjen
- Pranon pacientin nga Infermierja, shenon të dhënat në kartelë shëndetësore, merr anamnezën, bën ekzaminimin e pacientit (inspektimin, auskultimin, palpacionin dhe perkusionin), reanimimin kardio pulmonar dhe referon pacientin për hulumtime të tjera dijagnostike
- Bën diagnozën initiale dhe trajtimin me terapi adekuate
- Udhëzon tek specialisti konsulltant nëse është e nevojshme kosullta
- Kryen shërbime ne kuader të shëndetit reproductiv, kujdesit antenatal dhe postnatal
- Bën imunizimin (vaksinimin)
- Promovon edukimin shëndetsor
- Trajton lëndime të vogla
- Kryen vizita shtëpiake kur është e domosdoshme
- Bën identifikimin e grupeve vulnerable dhe të rrezikuara
- Bën dhënjën e barërave dhe medikamenteve esenciale
- Gjatë punës së tij i asistojnë infermieret
- Për punën e vet i përgjigjet Kryeshefit të DMF dhe Drejtorit.

Kualifikimi i kërkuara:

- Diploma e Fakultetit të Mjekësisë - Drejtimi i Përgjithshëm
- Licencë përkatëse të lëshuar nga organi kompetent
- Certifikantën e specializimit (për Specialistët)

II. Pozita: Mjek/e Specialist/e i Biokimisë Klinike - 1 (një) pozitë

Koeficienti: H - 20

Lloji i vendit të punës: Me afat të pacaktuar, me orar të plotë (Periudha provuese 6 (gjashtë) muaj.

Përshkrimi i detyrave të punës:

- Siguron shërbime laboratorike për të gjithë pacientët
- Realizon të gjitha analizat laboratorike të sektorit përkatës
- Vlerëson kualitetin e reagjentëve të punës dhe testeve
- Kujdeset për mirëmbajtje profesionale dhe funksionim të rregullt të aparaturës analitike
- Përcjell të rejtat e fundit nga lëmia e laboratorit dhe përkushtohet për aplikimin e tyre në bashkëpunim me Drejtorin e QKMF-së
- Bën përgaditjen e reagjentëve dhe tretjeve tjera të nevojshme dhe kujdeset që ato të jenë në sasi të mjaftushme
- Bën kontrollin e brendshëm dhe të jashtëm të kualitetit të punës
- Interpreton rezultatet laboratorike dhe konsulton drejtorin e QKMF-së sipas nevojës
- Ofron udhëzime profesionale për laborantët dhe kontrollon punën profesionale të tyre
- Bën dhe detyra tjera profesionale me urdhër të drejtorit, i përgjigjet dhe raporton atij.

Kualifikimi i kërkuara:

- Të ketë të përfunduar Fakultetin e Mjekësisë - Specialist Biokimi Klinike
- Certifikantën e specializimit
- Licencë përkatëse të lëshuar nga organi kompetent

III. Pozita: Infermier/e - 1 (një) pozitë

Koeficienti: 4.8

Lloji i vendit të punës: Me afat të pacaktuar, me orar të plotë (Periudha provuese 6 (gjashtë) muaj.

Përshkrimi i detyrave të punës:

- Pranon, triazhon dhe informon pacientin, hap kartelen shendetësore, merr anamnezen e shkurtër orjentuese, kryen participimin, matë gjatësin, peshën trupore, temperaturën, tensionin arterial, reanimimin kardiopulmonar, bën EKG, problemet geriatrike, aplikon terapinë parenteriale, IM, IV, subkutan, infuzion, inhalimin, përpunimin e plagës, këshillon pacientin, dhe udhëzon te mjeku familjar
- Në bashkëpunim me mjekun familjar ofron mbrojtjen primare shëndetësore për pacientin dhe familjen
- Promovon edukimin shendetësor
- Trajton lëndimet - plagët para dhe post operative
- Jep ndihmën shëndetësore në Institucion dhe vendin e ngjarjes
- Kryen vizita shtëpiake kur është e domostoshme me udhëzim të mjekut
- Bën injektimin e të gjitha mënyrave të mundshme (IM, IV, SC, ID etj)
- Kryen të gjitha punët administrative në lidhje me shërbimet që i bën
- Kryen edhe punë tjera sipas udhëzimit të mjekut.
- Bën transportimin e pacienteve të sëmurë nga QKMF deri ne institucionin me te avansuar(SHSHKUK) ne baze te udhëzimit të mjekut ordinar, e në raste urgjente edhe pa udhëzim por me arsyetim të më vonshëm.

-Për punën e vet i përgjigjet shefit të shërbimit dhe Drejtorit.

Kualifikimi i kërkuara:

- Diploma e shkollës së mesme të Mjekësisë
- Licencë përkatëse të lëshuar nga organi kompetent

IV. Teknik/e të Rentgenit - 2 (dy) pozita

Koeficienti: 5.4

Lloji i vendit të punës: Me afat të pacaktuar, me orar të plotë (Periudha provuese 6 (gjashtë) muaj.

Përshkrimi i detyrave të punës:

- Përgaditë vendin e punës (aparartet veglat dhe materialin) bënë identifikimin e pacientit, para fotografimit, vendos të sëmurin në pozitën përkatse në bazë të fotografimit që e bën.
- Radiografite i bën në mënyrë profesionale, kryen kontrollin e përpilimit teknik të rentgenit.
- Konsulton radiologun për kualitetin dhe inçizimin plotësues.
- Bën pranimin dhe fotografimin e pacientëve në bazë të udhëzimit të mjekut.
- Bën ndërrimin e kimikaleve në aparatit e zhvillimit të filmit.
- Radiografite e kryera me dokumentacion përkatës i përcjell te radiologu, i cili interpreton dhe përshkruan.
- Bën koordinimin me radiolog dhe administratë.
- Kujdeset mbi mjetet e punës (kasetat, filmat e rentgenit, kimikalet etj).
- Mbanë dozimetrit për kontroll dhe dozat e pranimit të rrezatimit (njëherë në vit shkon në enetet përkatës për kontrollim të rrezatimit).
- Rrepsisht ruan msheftësin profesionale i cili ka të bëjë me sëmundjet e pacientit.
- Kujdeset për mirëmbajtjen (pastrimin) e aparaturës.
- Kryen edhe punë tjera laboratorike-RO filmat.
- Gjatë punës është obligim mbajtja e dozimetrit dhe mjeteve mbrojtëse të punës.
- Kryen edhe punë tjera në kuadër të kualifikimit nga fushveprimi i tij.
- Bën kërkesat për furnizim me material hargjues.
- Mbanë dhe ruan dozimetrat.
- Për punën e vet i përgjigjet shefit të shërbimit dhe Drejtorit.

Kualifikimi i kërkuara:

- Të ketë të përfunduar Shkollën e Mesme të Mjekësisë/Bachelor - Teknik/e i Rentgenit
- Licencë përkatëse të lëshuar nga organi kompetent

V. Laborant/e - 2 (dy) pozita

Koeficienti: 5.4

Lloji i vendit të punës: Me afat të pacaktuar, me orar të plotë (Periudha provuese 6 (gjashtë) muaj.

Përshkrimi i detyrave të punës:

- Bën pranimin dhe evidentimin e pacientëve të cilët me udhëzime të mjekëve vijnë për analiza laboratorike
- Bën pranimin e materialit për analiza
- Vendos sendimentacionet dhe përcakton vlerat.
- Bën leximin e pasqyrave të gjakut.
- Pranon urinat, i punon dhe bënë etiketimin e tyre.
- Bën leximin e sendimentacionit të urinës në mikroskop.
- Kryen analizat biokimike siç janë: Glikemia, Urea, Kreatinina, Holesteroli, Trigliceridet, ALT- AST, Hepatogrami
- Sterilizon mjetet e punës.
- Për punën e vetë i përgjigjet shefit të shërbimit dhe Drejtorit.

Kualifikimi i kërkuara:

- Të ketë të përfunduar shkollën e mesme të mjekësisë - Teknik/e laboratorit ose në ndonjë lëmi tjetër të lidhur ngushtë me vendin e punës
- Licencë përkatëse të lëshuar nga organi kompetent

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR TË GJITHË KANDITATËT

Dokumentet e Kërkuara:

- Diploma e kualifikimit përkatës
- Dëshmia e Licencës dhe Specializimit aty ku kërkohet
- Kopja e Letërënjoftimit
- Çdo dokument tjetër apo certifikatë trajnimi
- Certifikatën që nuk jeni nën hetime
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion publik shëndetësor që dëshmon se gjendja e kandidatit është pa probleme shëndetësore (Kjo dëshmi sillet pas pranimit në mardhënie pune të kandidatit)
- Dokumentet i dërgoni fotokopje sepse të njëjtat nuk kthehen.

Afati i aplikimit:

Data e njoftimit në webfaqen unike të procedurave të konkurimit <https://konkursi.rks-gov.net> është prej dt. 15.02.2021 deri me dt.17.03.2021.

Afati për paraqitjen e aplikacioneve është 15 ditë, nga data 18.03.2021 deri me datën 02.04.2021.

Përveç web faqes unike të procedurave të konkurimit, konkursi publikohet edhe në web-faqe zyrtare të Komunës.

Komuna e Podujevës ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Fletëaplikacionet merren në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë, në ndërtesën e Kuvendit të Komunës.

Kërkesat me dokumente të kompletuara dorëzohen në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë.

Për çdo informatë plotësuese mund të kontaktoni në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, në këtë numër të telefonit 038 200 41-005.

Rezultatet shpallen në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net/>